

# Federata Ndërkombëtare Farmaceutike (FIP) – Plan Strategjik 2025–2030

Miratuar nga Këshilli i FIP-it, 31 Gusht 2025

## Kush jemi ne

### Praktikë – Shkencë – Edukim

Federata Ndërkombëtare Farmaceutike (FIP) është organ global për farmacinë, shkencat farmaceutike dhe edukimin farmaceutik. Si një federatë e organizatave kombëtare, organeve profesionale, institucioneve akademike, autoriteteve rregullatore, organeve akredituese dhe anëtarëve individualë, FIP përfaqëson mbi 5.5 milionë farmacistë, shkencëtarë farmaceutikë dhe profesorë të farmaceutikës në mbarë botën.

FIP ka anëtarë në më shumë se 80% të vendeve dhe territoreve të botës.

E themeluar në vitin 1912, FIP është një organizatë joqeveritare, me selinë qendrore në Holandë. Përmes rrjeteve dhe partneriteteve të gjera në fushën e farmacisë, shkencave farmaceutike dhe edukimit farmaceutik, FIP punon për të mbështetur zhvillimin e profesionit farmaceutik, duke u fokusuar në praktikën profesionale, inovacionet shkencore në zhvillim dhe zhvillimin e fuqisë punëtore farmaceutike, me qëllim përmbushjen e nevojave dhe pritshmërive globale të kujdesit shëndetësor.

FIP njihet si lideri global në fushën e farmacisë.

FIP vazhdon të zgjerojë praninë e saj në farmaci dhe shkencat farmaceutike, duke ushtruar ndikim në këtë fushë përmes partneriteteve me disa nga institucionet më të rëndësishme botërore në shëndetësi, hartimin e politikave, arsim dhe shkencë.

## Përmbajtja

- 4 Parathënie
- 5 Transformimi i farmacisë për të ndërtuar një botë më të mirë
- 6 Vizioni ynë
- 7 Misioni ynë
- 8 Vlerat tona
- 10 Plani ynë i veprimit
- 12 Rezultatet tona strategjike
- 18 Grupi i Punës i Zyrës/Departamentit tonë

## Parathënie

Për më shumë se një shekull, Federata Ndërkombëtare Farmaceutike (FIP) ka udhëhequr përparimin e farmacisë në mbarë botën, duke fuqizuar farmacistët, shkencëtarët farmaceutikë dhe profesorët për të përmirësuar rezultatet shëndetësore të komuniteteve kudo.

Ndërsa sistemet e kujdesit shëndetësor evoluojnë dhe shfaqen sfida të reja globale, FIP mbetet e përkushtuar për të siguruar që profesioni farmaceutik të vazhdojë të lulëzojë — si një shtyllë e kujdesit shëndetësor e udhëhequr nga shkenca, e përqendruar te pacienti dhe e gatshme për të ardhmen.

Ky Plan Strategjik 2025–2030 përcakton vizionin e përbashkët të FIP-it për një botë ku të gjithë kanë akses në barna të sigurta, efektive, cilësore dhe të përballueshme, teknologji shëndetësore dhe shërbime të kujdesit farmaceutik, të mbështetura nga praktika të qëndrueshme dhe bashkëpunime inovative me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor. I udhëhequr nga qasja ONE FIP, ky plan bashkon praktikën, shkencën dhe edukimin për të nxitur inovacionin, për të forcuar fuqinë punëtore dhe për të siguruar akses të barabartë në kujdes cilësor.

Plani fokusohet në prioritetet kyçe, përfshirë qëndrueshmërinë e fuqisë punëtore, qëndrueshmërinë ekonomike të praktikës farmaceutike, transformimin digjital, qëndrueshmërinë dhe rezistencë ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe harmonizimin me Objektivat e Zhvillimit të FIP-it dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Duke punuar së bashku përmes kësaj strategjie, FIP dhe organizatat e saj anëtare do të rrisin ndikimin global të profesionit, do të formësojnë politika shëndetësore progresive dhe do të ndërtojnë sisteme më të forta të kujdesit shëndetësor për të ardhmen. Të bashkuar nga qëllimi dhe të udhëhequr nga shkenca, FIP do të vazhdojë të zhvillojë farmacinë në mbarë botën — për shëndetin e njerëzve dhe të planetit.

**Përpara me Farmacinë,  
Përpara me FIP-in**

**Paul Sinclair, AM  
President  
Federata Ndërkombëtare Farmaceutike**

---

## Transformimi i farmacisë për të ndërtuar një botë më të mire

Që prej vitit 1912, Federata Ndërkombëtare Farmaceutike (FIP) ka udhëhequr përparimin global të profesionit farmaceutik — duke bashkuar farmacistë, shkencëtarë dhe profesorë për të përmirësuar rezultatet shëndetësore në mbarë botën. Ndërsa sistemet e kujdesit shëndetësor evoluojnë dhe sfidat globale bëhen gjithnjë e më komplekse, FIP mbetet e përkushtuar për të mbështetur një fuqi punëtore farmaceutike të kualifikuar, të fuqizuar dhe të pajisur për të përmbushur si nevojat aktuale, ashtu edhe ato të ardhshme shëndetësore.

Ky Plan Strategjik përshkruan vizionin e FIP-it për transformimin e farmacisë në të gjitha rajonet dhe sektorët. Në thelb të tij qëndron angazhimi për të forcuar marrëdhëniet me organizatat anëtare dhe anëtarët individualë, duke siguruar që veprimtaria jonë t'u përgjigjet nevojave të ndryshme rajonale, ndërkohë që mbetet në përputhje me prioritetet globale të shëndetit.

Ne e pranojmë se qëndrueshmëria e farmacisë nuk mbështetet vetëm në zhvillimin profesional, por edhe në qëndrueshmërinë ekonomike. FIP mbron modele financimi dhe shpërblimi që pasqyrojnë rolin në zgjerim të farmacistëve — veçanërisht në mjediset komunitare — si ofrues të aksesueshëm të kujdesit shëndetësor në vijën e parë, që ofrojnë kujdes të përqendruar te pacienti.

Farmacia duhet gjithashtu të luajë një rol aktiv në adresimin e ndryshimeve klimatike dhe qëndrueshmërisë mjedisore. FIP po punon për të integruar përgjegjësinë mjedisore në praktikën farmaceutike, edukim dhe shkencë — nga gatishmëria ndaj fatkeqësive dhe sigurimi i aksesit në barna gjatë krizave, deri te prodhimi i gjelbër dhe zinxhirët e përgjegjshëm të furnizimit.

Njëkohësisht, shëndetësia digjitale, automatizimi dhe përparimet shkencore, si gjenomika dhe biologjikët, po ripërcaktojnë ofrimin e kujdesit shëndetësor. FIP do të ndihmojë profesionin të përqafojë inovacionin, të forcojë bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe të zgjerojë rolin e farmacistëve në mjekësinë e personalizuar dhe menaxhimin e sëmundjeve.

Ky Plan Strategjik udhëhiqet nga vizioni, misioni dhe rezultatet e rifreskuara të FIP-it, të mbështetura nga Objektivat e Zhvillimit të FIP-it — udhërrëfyesi ynë për progres të matshëm gjatë pesë viteve të ardhshme. Këto objektiva janë në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, duke siguruar që farmacia të kontribuojë në mënyrë domethënëse në përmirësimin e shëndetit global.

Përmes qasjes “ONE FIP”, ne bashkojmë praktikën, shkencën dhe edukimin për të ofruar një zë të fortë dhe koheziv për farmacinë. Duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet qeverive, akademisë, industrisë dhe sistemeve shëndetësore, FIP synon të formësojë një profesion rezilient dhe të orientuar drejt së ardhmes — një profesion që avancojnë aksesin, barazinë dhe inovacionin në kujdesin shëndetësor.

**Së bashku, nën identitetin e përbashkët të farmacisë, po ndërtojmë një botë më të shëndetshme.**

---

## Vizioni ynë

### I aksesueshëm – I përballueshëm – I qëndrueshëm

Një botë ku të gjithë kanë akses në barna, teknologji shëndetësore dhe shërbime të kujdesit farmaceutik të sigurta, efektive, cilësore dhe të përballueshme, të mbështetura nga praktika të qëndrueshme dhe bashkëpunime inovative me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor.

---

## Misioni ynë

### Mbështetja – Advokimi – Nxitja

FIP mbështet shëndetin global duke avancuar praktikën farmaceutike, shkencat dhe edukimin, duke advokuar për rolin e farmacistëve në sistemet e kujdesit shëndetësor në mbarë botën, duke promovuar akses të barabartë në barna dhe shërbime kujdesi, si dhe duke nxitur qëndrueshmërinë në farmaci për të adresuar sfida kritike si ndryshimet klimatike dhe pabarazitë globale në shëndetësi.

## Vlerat tona

### Integritet – Pasion – Performancë

#### Integritet

Në FIP, integriteti është një vlerë përcaktuese që frymëzon besim dhe respekt. Ne jemi të përkushtuar ndaj standardeve më të larta të etikës, transparencës dhe përgjegjshmërisë në çdo gjë që bëjmë. Ky përkushtim i palëkundur ndërton besim të qëndrueshëm me anëtarët, partnerët dhe komunitetin global të kujdesit shëndetësor. Integriteti jo vetëm që udhëheq vendimet dhe politikat tona — ai pasqyron se kush jemi dhe si formojmë në mënyrë pozitive të ardhmen e kujdesit shëndetësor së bashku.

#### Pasion

Në FIP, pasioni është fuqia që drejton misionin tonë për të avancuar profesionin farmaceutik dhe për të përmirësuar shëndetin global. Ai na frymëzon të inovojmë, të sfidojmë status quo-në dhe të ndjekim ndryshime me kuptim dhe vendosmëri. Komuniteti ynë i gjallë i anëtarëve, partnerëve dhe bashkëpunëtorëve ushqen këtë pasion — duke ndarë kohën, njohuritë dhe përkushtimin e tyre për të shërbyer më mirë pacientët dhe komunitetet. Pasioni është ajo që na bashkon dhe na fuqizon të vazhdojmë për një botë më të shëndetshme dhe më të barabartë.

#### Performancë

Në FIP, performanca pasqyron ndikimin që ne kemi dhe rezultatet që arrijmë përmes përkushtimit, bashkëpunimit dhe ekselencës. Ne jemi të motivuar për të sjellë rezultate të dobishme në çdo projekt, iniciativë dhe partneritet — duke siguruar që puna jonë të çojë në ndryshime reale dhe të qëndrueshme. Bazuar në përgjegjshmëri dhe veprim të bazuar në prova, ne matim suksesin jo vetëm nga ajo që arrijmë, por edhe nga ndryshimi pozitiv që sjellim në shëndetin global.

## FIP synon të...

- Adresojë qëndrueshmërinë në praktikat farmaceutike dhe shkencat farmaceutike
- Advokojë për forcimin e sistemeve shëndetësore, përfshirë kujdesin shëndetësor primar
- Pozicionojë farmacistët si anëtarë integralë të ekipeve të kujdesit primar
- Përmirësojë investimin në fuqinë punëtore shëndetësore
- Promovojë farmacinë si pika e parë e aksesit për shërbime të kujdesit farmaceutik
- Forcojë integritetin e zinxhirit farmaceutik të furnizimit, duke njohur mungesat e barnave
- Mbështesë barazinë në aksesin ndaj kujdesit shëndetësor
- Përmirësojë rezultatet shëndetësore përmes parandalimit dhe promovimit të shëndetit publik
- Bashkëpunojë në përpjekje humanitare, fatkeqësi dhe gatishmëri për emergjenca
- Inovojë praktikën farmaceutike përmes avancimeve shkencore në ndërhyrjet terapeutike
- Luftojë barnat e dobëta dhe të falsifikuara
- Mbështesë arsimimin profesional dhe pasuniversitar
- Mbështesë zhvillimin dhe rregullimin e barnave dhe teknologjive shëndetësore bazuar në shkencë për të përmbushur nevojat e kujdesit shëndetësor
- Forcojë rrjetet globale dhe të harmonizohet me organizatat ndërkombëtare
- Promovojë praktikën bashkëpunuese në të gjitha mjediset
- Advokojë për përdorimin e plotë të ekspertizës së farmacistëve për përfitimin e njerëzve dhe sistemeve shëndetësore

## **Përcaktimi i prioriteteve – Drejtimi drejt qëllimeve (objektivave) - Mbikëqyrja e procesit**

### **Udhërrëfyshi ynë**

Vendosmëri  
Udhëzim  
Leadership

Ky Plan Strategjik është më shumë se një dokument politikash — ai përfaqëson një udhërrëfyes të përbashkët për profesionin farmaceutik gjatë pesë viteve të ardhshme. Ai fillon duke identifikuar dhe duke iu përgjigjur kërcënimeve dhe sfidave kryesore globale shëndetësore që presim deri në vitin 2030, që nga mungesat e fuqisë punëtore dhe çështjet e aksesit në barna, deri te ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe transformimit digjital.

### **Udhërrëfyshi**

Ky udhërrëfyes përcakton prioritetet e profesionit për pesë vitet e ardhshme, duke u harmonizuar me këto presione dhe mundësi globale. Ai përfshin:

- Forcimin e edukimit
- Avancimin e shkencës
- Përmirësimin e aksesit të barabartë në kujdes shëndetësor
- Mbështetjen e rolit të farmacistëve në kujdesin primar dhe shëndetin publik

Plani gjithashtu rikthehet dhe riafirmon vizionin dhe misionin e FIP-it, duke siguruar që ato të mbeten të rëndësishme dhe ambicioze përballë realiteteve të sotme. Në fund, ai është dizajnuar për të siguruar që të gjitha pjesët e Federatës — organizatat anëtare, seksionet, bordet dhe partnerët — të mund të harmonizojnë punën dhe strategjitë e tyre për të realizuar këtë vizion të përbashkët.

## Busulla (Drejtimi)

Busulla që udhëhoqi zhvillimin e këtij Planit Strategjik janë Objektivat e Zhvillimit të FIP-it (FIP Development Goals) dhe Deklaratat e Politikës (Statements of Policy). Në shtator 2020, FIP publikoi një grup prej 21 Objektivash Zhvillimi (DGs) që bashkojnë fuqinë punëtore dhe edukimin, praktikën dhe shkencën në një kuadër transformues, duke përcaktuar një profesion farmaceutik më të avancuar dhe të përmirësuar për dekadën e ardhshme. Deklaratat e Politikës së FIP-it përfaqësojnë pozicionet globale të konsensusit mbi çështjet kryesore profesionale dhe shëndetësore globale (të lidhura me sfidat globale shëndetësore të identifikuar nga OBSH).

## Timoni i drejtimit

Byroja / Bordi i Integruar i FIP-it do të mbikëqyrë implementimin e Planit Strategjik në të gjithë FIP-in dhe të gjitha komunitetet përkatëse. Duke përmbyshur rolin e një timoni drejtimi, ata do të sigurojnë që të gjitha aktivitetet dhe iniciativat e FIP-it të drejtohen drejt realizimit të Planit Strategjik.

Duke kombinuar këtë Plan Strategjik me plane veprimi vjetore fleksibël, FIP ka krijuar një strukturë që është në të njëjtën kohë e qëndrueshme dhe e përgjegjshme. Kjo qasje i lejon FIP-it të përshtatet shpejt, të qëndrojë në linjë me zhvillimet e reja, të përdorë burimet më efektivisht dhe të vazhdojë të përmirësohet me kalimin e kohës — të gjitha duke mbajtur misionin e saj të përbashkët në fokus të qartë.

## Rezultatet strategjik #1

### Akses në Barnat dhe Shërbimet Shëndetësore

FIP synon të sigurojë që të gjithë individët, pa marrë parasysh vendndodhjen ose statusin socio-ekonomik, të kenë akses në barnat dhe shërbimet shëndetësore që u nevojiten.

#### Duke u bazuar në punën e mëposhtme të FIP-it:

##### Deklaratat e Politikës së FIP-it:

- Zhvillimi strategjik i informacionit mbi barnat për përfitimin e pacientëve dhe përdoruesve të barnave (2023)
- Roli i farmacistit në menaxhimin e fatkeqësive dhe emergjencave (2023)
- Roli i farmacisë në vaksinimin gjatë gjithë jetës (2023)

##### Deklarata e Parimeve e FIP-it:

- Ndikimi i pandemisë COVID-19 mbi barazinë në shëndetësi dhe mbi pacientët dhe popullatat e ndjeshme (2020)

## FIP synon të...

**1.1** Advokojë për akses universal në barna dhe kujdes shëndetësor nën parimet e Mbulimit të Shëndetit Universal (UHC), duke harmonizuar shërbimet farmaceutike me objektivat e UHC-së.

**1.2** Bashkëpunojë me agjenci globale për të parandaluar dhe zbutur mungesat e barnave dhe për të siguruar integritetin e zinxhirit farmaceutik të furnizimit.

**1.3** Promovojë praktika të qëndrueshme prodhimi dhe shpërndarjeje për të minimizuar ndikimet mjedisore.

**1.4** Sigurojë integritetin e zinxhirit farmaceutik të furnizimit duke luftuar barnat e dobëta dhe të falsifikuara, duke forcuar kuadrot rregullatore, duke mbështetur farmacistët dhe duke promovuar akses të barabartë në barna të sigurta, efektive dhe të përballueshme, në përputhje me misionin e FIP-it për avancimin e shëndetit global.

**1.5** FIP vazhdon të mbështesë zgjerimin dhe njohjen e shërbimeve farmaceutike që adresojnë nevojat bashkëkohore shëndetësore. Lehtësimi i farmacistëve për të ofruar kujdes të aksesueshëm — si vaksinimet, kontrollet shëndetësore, mbështetja për sëmundjet kronike dhe këshillimi për vetëkujdesin — kontribuon në sisteme më të qëndrueshme dhe të përgjegjshme të kujdesit primar shëndetësor. Ky zgjerim i shërbimeve gjithashtu mbështet evoluimin dhe qëndrueshmërinë e profesionit.

## Rezultateti strategjik #2

### Kujdes Farmaceutik i Përqendruar te Personi dhe Mirëqenia

FIP synon të forcojë rolin e farmacistëve në kujdesin ndaj pacientit duke siguruar që individët të jenë të informuar dhe të fuqizuar për të marrë vendime të bazuara mbi shëndetin e tyre.

#### Duke u bazuar në punën e mëposhtme të FIP-it:

##### Deklaratat e Politikës së FIP-it:

- Zhvillimi strategjik i informacionit mbi barnat për përfitimin e pacientëve dhe përdoruesve të barnave (2023)
- Roli i farmacistëve në vaksinimin gjatë gjithë jetës (2023)

##### Deklarata e Parimeve të FIP-it:

- Ndikimi i pandemisë COVID-19 mbi barazinë në shëndetësi dhe mbi pacientët dhe popullatat e ndjeshme (2020)

## FIP synon të...

**2.1** Sigurojë udhëheqje në ndihmën që farmacistët ofrojnë informacion të saktë dhe të aksesueshëm mbi barnat, teknologjitë shëndetësore dhe shërbimet, për të maksimizuar përfitimin e pacientit. Për të garantuar përdorimin e sigurt dhe efektiv të barnave, është thelbësore që një farmacist i kualifikuar të jetë i pranishëm sa herë dhe kudo që barnat shpërndahen. Ekspertiza e tyre është kritike për ofrimin e këshillimit të saktë ndaj pacientit dhe për sigurimin e përputhshmërisë me standardet rregullatore dhe të sigurisë.

**2.2** Edukoni dhe fuqizoni farmacistët për të marrë rolet aktive në vaksinimin farmaceutik (PBV): administrimi i vaksinave, fushatat dhe strategjitë e vaksinimit, edukimi për kujdesin parandalues, menaxhimi i sëmundjeve kronike dhe sëmundjeve jo-infektive (NCD) për të ofruar kujdes farmaceutik të përqendruar te personi, duke siguruar kujdes gjithëpërfshirës që adreson spektrin e plotë të nevojave të pacientit.

**2.3** Mbështet politikë të barabartë dhe gjithëpërfshirëse që priorizon popullatat e pambuluara dhe të ndjeshme.

**2.4** Sigurojë një fuqi punëtore farmaceutike të qëndrueshme dhe të motivuar: FIP do të promovojë strategji që mbështesin mirëqenien profesionale, autonominë dhe kënaqësinë në punë. Këta faktorë janë të domosdoshëm për ruajtjen, performancën dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të shërbimeve farmaceutike. Duke nxitur ambiente pune të shëndetshme dhe duke vlerësuar kontributet e farmacistëve, shkencëtarëve dhe edukatorëve, FIP do të ndihmojë në forcimin e fuqisë punëtore farmaceutike globale.

**2.5** Edukoni dhe fuqizoni farmacistët për të promovuar parandalimin e sëmundjeve, promovimin e shëndetit dhe gatishmërinë për fatkeqësi, duke siguruar një qasje holistike ndaj kujdesit ndaj pacientit, ndërkohë që zgjeroni përpjekjet e tyre në parandalimin e sëmundjeve dhe menaxhimin e sëmundjeve kronike dhe NCD, për të ulur kostot e kujdesit shëndetësor, përmirësuar rezultatet e pacientëve dhe përforcuar besimin publik në kujdesin e udhëhequr nga farmacistët.

**2.6** Adresimi i mungesave të fuqisë punëtore është një prioritet kritik: FIP është e përkushtuar të identifikojë strategji që përmirësojnë ruajtjen e fuqisë punëtore, përfshirë edukimin, zhvillimin e karrierës dhe sistemet që rrisin mirëqenien, autonominë dhe kënaqësinë në punë të farmacistëve. Forcimi i këtyre aspekteve kontribuon drejtpërdrejt në aftësinë e profesionit për të përmbushur kërkesat shëndetësore të së ardhmes.

## Rezultatet strategjik #3

### Inovacioni dhe Shkencat Farmaceutike

FIP synon të mbështesë dhe të advokojë për zhvillimin e barnave, teknologjive dhe shërbimeve të reja, duke siguruar që këto inovacione të përdoren në mënyrë efektive.



**Duke u bazuar në punën e mëposhtme të FIP-it:**

**Deklarata e Politikës së FIP-it:**

- Sigurimi i cilësisë në edukimin farmaceutik dhe në shkencat farmaceutike (2022)

**FIP synon të...**

**3.1** Mbështesë nismat që promovojnë zbulimin dhe zhvillimin e barnave të reja, terapive dhe teknologjive shëndetësore në bashkëpunim me komunitetet shkencore, duke avokuar për investime të vazhdueshme në kërkimin farmaceutik.

**3.2** Zhvillojë politikë ndërkombëtare për kujdesin farmaceutik, kërkimin dhe edukimin, për të promovuar përputhshmërinë dhe barazinë.

**3.3** Lehtësojë ofrimin e qëndrueshëm dhe të barabartë të shërbimeve farmaceutike, duke përfshirë përdorimin e përgjegjshëm të teknologjive dhe inovacioneve të reja.

**3.4** Mbështesë arsimimin dhe trajnimin në barnat dhe teknologjitë inovative, si gjenetika, farmacogenomika dhe mjekësia e personalizuar, për të përgatitur farmacistët për terapitë dhe inovacionet e reja.

## **Rezultateti strategjik #4**

### **Forcimi i Kujdesit Farmaceutik dhe Zhvillimit të Fuqisë Punëtore**

FIP synon të sigurojë që fuqia punëtore farmaceutike të jetë e pajisur, e fuqizuar dhe e mbështetur për të ofruar kujdes me cilësi të lartë, duke kontribuar në përmirësimin e rezultateve shëndetësore në mbarë botën.

**Duke u bazuar në punën e mëposhtme të FIP-it:**

**Deklaratë e Politikës së FIP-it mbi:**

- Sigurimin e cilësisë në arsimin e farmacistëve dhe shkencave farmaceutike (2022)

**FIP synon të...**

**4.1** Mbështesë arsimimin dhe trajnimin e farmacistëve për të ofruar kujdes farmaceutik të përqendruar te personi dhe për të përmirësuar rezultatet shëndetësore për individët dhe popullatat. FIP është e përkushtuar të mbështesë dhe të advokojë për një kuadër rregullator rajonal që promovon zhvillimin e profesionit farmaceutik. Një i tillë kuadër është thelbësor për forcimin e zhvillimit të fuqisë punëtore, avancimin e edukimit dhe përmirësimin e kujdesit farmaceutik.

**4.2** Advokojë për kujdes farmaceutik të qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë në sistemet shëndetësore, duke siguruar përdorimin e përgjegjshëm të barnave. Pajis farmacistët me aftësi për të adresuar sfidat e shëndetit publik, duke përfshirë vaksinimet dhe menaxhimin e sëmundjeve kronike, ndërkohë që mbështet trajnimin e fuqisë punëtore në kujdesin parandalues.

**4.3** Ul keqpërdorimin dhe abuzimin me barnat përmes programeve gjithëpërfshirëse të edukimit dhe ndërhyrjes për pacientët, ofruesit e shëndetit dhe aktorët e tjerë të përfshirë.

**4.4** Advokojë për qëndrueshmërinë e fuqisë punëtore duke përmirësuar mundësitë për edukim dhe zhvillim profesional, dhe duke zbatuar strategji për të adresuar mungesën dhe pabarazinë globale të farmacistëve, duke siguruar akses të barabartë tek profesionistët e kualifikuar dhe përmirësuar ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe rezultatet për pacientët.

## Rezultateti strategjik #5

### Rezistenca ndaj Antimikrobikëve (AMR) dhe një Qasje “Bashkë për Shëndetin”

FIP synon të luajë një rol kyç në luftën globale kundër rezistencës ndaj antimikrobikëve (AMR), duke siguruar përdorim të përgjegjshëm të barnave dhe duke bashkëpunuar me organizata shëndetësore në mbarë botën.

**Duke u bazuar në punën e mëposhtme të FIP-it:**

**Deklarata e Politikës së FIP-it:**

- Zbutja e rezistencës ndaj antimikrobikëve përmes menaxhimit të përgjegjshëm të antibiotikëve (antimicrobial stewardship) (2023)

**Deklarata e Parimeve e FIP-it:**

- Ndikimi i pandemisë COVID-19 mbi barazinë në shëndetësi dhe mbi pacientët dhe popullatat e ndjeshme (2020)

**FIP synon të...**

**5.1** Bashkëpunojë dhe krijojë partneritete me organizatat globale dhe rajonale për të zhvilluar politika dhe praktika që reduktojnë përhapjen e AMR përmes përdorimit të përgjegjshëm të barnave.

**5.2** Mbështesë Organizatat Anëtare të FIP-it për të bashkëpunuar me qeveritë kombëtare, sistemet shëndetësore dhe industrinë farmaceutike, për të mbështetur zhvillimin e agjentëve të rinj antimikrobikë dhe alternativave.

**5.3** Angazhohet me organizatat shëndetësore ndërkombëtare dhe rajonale për të zhvilluar strategji globale për arsim, parandalim dhe monitorim të AMR.

**5.4** Advokojë për integrimin e shëndetit planetar në luftën kundër rezistencës ndaj antimikrobikëve (AMR). Si pjesë e qasjes ONE HEALTH të OBSH-së, ne njohim ndërvarësinë midis shëndetit mjedisor, shtazor dhe njerëzor. Ne theksojmë praktika të qëndrueshme për të reduktuar përhapjen e AMR, duke promovuar një qasje holistike që mbron si shëndetin publik, ashtu edhe mjedisin për gjeneratat e ardhshme.

## Rezultateti strategjik #6

### Udhëheqja, Qeverisja dhe Angazhimi Global

FIP synon të përmirësojë kapacitetin e saj për të shërbyer anëtarët, për të zhvilluar udhëheqësit e së ardhmes dhe për të marrë vendime strategjike që promovojnë shëndetin global, duke avancuar praktikat farmaceutike, shkencat dhe edukimin.

**Duke u bazuar në punën e mëposhtme të FIP-it:**

**Deklarata e Politikës së FIP-it:**

- Roli i farmacistit në menaxhimin e fatkeqësive dhe emergjencave **(2023)**
- Roli i farmacisë në vaksinimin gjatë gjithë jetës **(2023)**
- Qëndrueshmëria mjedisore brenda farmacisë **(2023)**
- Praktika farmaceutike miqësore ndaj mjedisit: Farmacia e gjelbër **(2016)**

Deklarata Qindvjetore e FIP-it (2012, Amsterdam)

**FIP synon të...**

**6.1** Sigurojë që të gjitha vendimet dhe iniciativat të fokusohen në përfitimin e anëtarëve të FIP-it, duke njohur nevojat e ndryshme nëpër rajone, dhe në disiplinat, sektorët dhe specialitetet e ndryshme të profesioneve tona.

**6.2** Nxisë zhvillimin e udhëheqësve të së ardhmes në farmacinë, duke promovuar trajnime udhëheqëse nëpër vende, rajone dhe sektorë.

**6.3** Lehtësojë ndarjen e njohurive dhe mjeteve për zhvillim profesional për farmacistët, edukatorët dhe shkencëtarët farmaceutikë në nivel global, duke shfrytëzuar IT dhe platformat digjitale.

**6.4** Përmirësojë proceset e vendimmarrjes për të mundësuar qeverisje efektive, duke siguruar që FIP të përshtatet ndaj ndryshimeve dhe të mbetet udhëheqës në advokimin për shëndetin global.

**Grupi punues i zyrës sonë**

Ky Plan Strategjik u zhvillua nga Grupi ynë i Dedikuar i Punës. U kërkuar feedback nga organizatat anëtare të FIP-it, seksionet dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë të FIP-it përmes një procesi formal konsultimi. Komentet e menduara, vlerësimet kritike dhe sugjerimet konstruktive kanë qenë të paçmuara në formësimin e një strategjie që reflekton diversitetin, nevojat dhe prioritetet e profesionit farmaceutik global.

Kjo ka qenë një përpjekje vërtet kolektive.

**Përktheu nga origjinali**

**Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë**



**P R E S I D E N T**

**Defrim GOMA**